



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.205/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Kymete Kicaj - kryesuese, Arsim Hamzaj dhe Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunes së Klllokotit, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur me 15.10.2025, merr këtë:

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ankesa ZL.Anr.205/2025, e datës 13.10.2025, e parashtruar nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datën 13.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, me të cilën pretendon se me datë 12.10.2025 në Klllokot në Zgjedhjet Lokale në Klllokot, Serbia ka ndërhyrë në sistemin Zgjedhor në Komunen e Klllokotit duke fabrikuar dëshmi mjekësore serbe të strukturave paralele për tu shfrytëzuar votuesit me asistencë të përdorin këtë vërtetim mjekësor. Votuesit shqiptar nuk kanë mundur të realizojnë këtë të drejt sepse nuk kanë pasur vërtetime mjekësore valide të Republikës së Kosovës, por Lista Serbe dhe SNS kanë organizuar këtë metodë të kundër Rendit Kushtetuese se Republikës së Kosovës me qellim që të ndërhyj dhe të ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve në Klllokot me këto dokumente jo valide të cilat në asnjë moment nuk ishin të njoftuar komisionerët dhe vëzhguesit e asnjë subjekti politik se nuk duhet ti lejohet votimi me këto dokumente të Republikës së Serbis të lëshuara në Kosovë. Të gjitha votat me asistencë kanë përdorur dëshmi mjekësore vetëm nga institucionet shëndetësore jo valide në Kosovë dhe në disa raste nga vërtetime të falsifikuara edhe nga ndonjë institucion shëndetësor nga sistemi i RKSK. Tutje ka shtuar se, në shkollën “Sveti Sava” në Klllokot kjo metodë ka ndikuar në rezultatin zgjedhor dhe sipas informacioneve që janë ardhë nga vëzhguesit në këtë shkollë në vendvotimin me numër: 3701-SH.F.M.U Sveti Sava në Klllokot. Vendvotimet: 3701/02 janë shkelur te drejtat themelore të njeriut dhe është shkelur procedura për numërimin e fletëvotimeve të votimit. Në këto dy vendvotime janë konstatuar nga ana e

vëzhguesve të mi se nuk ka filluar procesi i numërimit në kohen e duhur, por në fillim janë hapur dy kutit dhe pastaj kanë filluar numërimin e votave vetëm për kuvend komunal dhe me vone për kryetar të komunës Klllokotit. Dyshimet tona janë esenciale dhe ndërhyjnë në rezultatin e zgjedhjeve sepse edhe votimi me asistencë me këtë metodë ka ndikuar në këtë vendvotim dhe në të gjitha vendvotimet tjera kanë pasur ndikim dhe efekt që ndikojnë direkt në jetën e çdo qytetari në Klllokot. Kërkoj nga PZAP të marr vendim mbi rinumërimin e të gjitha vendvotimet në komunën e Klllokotit dhe nëse konstatohen këto veprime të Serbisë apo Listës Serbe dhe SNS në Klllokot, kërkoj nga ana juaj që të anulohen vendvotimet me asistencë me dokumente mjekësore të Serbisë jovalide në RKS dhe të përsëritet votimi në komunën e Klllokotit për kryetar komune në të gjitha ku konstatohet këto veprime të Serbisë në zgjedhjet në Klllokot, vendvotimet në Klllokot që kërkojmë të përsëritet votimi janë vendvotimi: 3701/02.

Parashtruesi i ankesës lidhur me pretendimet e tij ka bashkangjitur si provë dëshmi e kryerjes së veprimit, përkatësisht dokumentin mjekësor të lëshuar nga Republika e Serbisë.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Lista, me datë 14.10.2025, ka deklaruar se kjo ankesë është paradoksale, e pabazuar dhe absolutisht e paarsyeshme nga ana juridike. Para së gjithash, si subjekt legal politik në Kosovë, në nuk kemi kompetenca mbi institucionet shëndetësore, qofshin ato që funksionojnë në sistemin serb apo kosovar. Duke u nisur nga ky fakt, nuk shohim të kuptimtë që ankesa të referohet subjektit tonë politik. Po ashtu, ne as nuk e dimë dhe as nuk mund ta dimë se nga erdhi kjo dëshmi, si dhe pse u lëshua, dhe ajo që është më e rëndësishme, ne nuk mund të jemi përgjegjës për veprimet e ndonjë personi tjetër juridik apo fizik. Në ankesën e tij, z. Emini në mënyrë të papërcaktuar thotë se dikush, pa i përmendur emrat e personave, numrin e tyre, vendin ku votuan, as lidhjen midis personit/ave të përmendur dhe subjektit tonë politik. Shtrohet pyetja se si e di z. Emini se ata persona janë votues ose anëtarë të Listës Serbe. Në qendrën zgjedhore të përmendur, edhe z. Emini fitoi 230 vota. Gjithashtu, përveç deklaratës së tij, nuk ka asnjë provë që ngjarja e përmendur ka ndodhur, dhe letra me diagnozën e shkruar është pa emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin bëhet fjalë. E drejta e personave për të përdorur asistencë është e rregulluar me akte juridike. Në vetë vendvotimin, vendimin për të lejuar votimin me ndihmën e një asistenti e marrin anëtarët e komisioneve zgjedhore, dhe në këtë kuptim Lista Serbe nuk mund të ketë ndikuar në faktin nëse do të lejohej apo jo votimi me asistencë, dhe për këtë arsye as nuk mund të mbartë përgjegjësi për këtë ngjarje të supozuar. Z. Emini në ankesën e tij ZL.Anr. 205/2025 kundër subjektit tonë politik ka theksuar gjithashtu se ka pasur vonesë në procesin e numërimit të votave në vendvotimin 3701/02 në komunën e Klllokotit, dhe për këtë e ka akuzuar subjektin tonë politik. Kujtojmë se procesin e numërimit të votave e kryejnë anëtarët e komisioneve zgjedhore në përputhje me rregullat. Pa dashur të hyjmë në detaje, nuk shohim asnjë bazë që për punën e komisionit zgjedhor të fajësohet subjekti ynë politik i cili ka vetëm një anëtar në komisionin zgjedhor. Sipas të dhënave tona, për këto ngjarje të supozuara nuk është paraqitur asnjë ankesë në librin e procesit të votimit. Duke pasur parasysh faktet e përmendura që kemi cituar në përgjigjen tonë ndaj ankesës së pabazuar të z. Emini, kërkojmë nga PZAP që të njëjtën të refuzoj si të pabazuar.

Në përgjigjen në ankesë subjekti politik Srpska Narodna Sloga (SNS) të datës 14.10.2025, ka deklaruar se Srpska Narodna Sloga, si subjekt politik, pohon se ne nuk kemi përdorur dëshmitë mjekësore të përmendura dhe as nuk kemi marrë pjesë në lëshimin e dëshmive të tilla mjekësore; nëse vërtetohet e kundërta, jemi gati të përgjigjemi juridikisht. Theksojmë se SNS si subjekt politik nuk mund të mbajë përgjegjësi dhe pasoja ligjore as për dëshmitë mjekësore, pasi nuk i ka përdorur, e aq më pak për lëshimin e tyre, as për numërimin e votave në vendvotimet e Shkollës Fillore "Sveti Sava", pasi ne nuk kishim anëtarë të komisionit në ato vendvotime dhe as vëzhgues, prandaj nuk mund të kishim marrë pjesë në këto parregullsi, nëse ka pasur të tilla. Kandidati i pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, thotë se në procesin zgjedhor është futur shteti i Serbisë, por gjithashtu ekziston dyshimi i bazuar se në procesin zgjedhor për zgjedhjet lokale në komunën e Klllokotit është futur edhe shteti i Kosovës, veçanërisht Agjencia Kosovare e Informimit, dhe ka ushtruar presion mbi votuesit që të votojnë pikërisht për kandidatin e pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Eminin, gjë që përben vepër penale. Gjithashtu, në ankesë thuhet se duhet të anulohen rezultatet e zgjedhjeve për vendvotimin në Shkollën Fillore "Sveti Sava" në Klllokot. Megjithatë, nga dëshmia që është bashkangjitur ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, shihet se bëhet fjalë për votuesen Gordana Jerinić nga Grnçari. Gordana Jerinić nuk voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Sveti Sava" në Klllokot, por voton në vendvotimin e Shkollës Fillore "Marko Rajković" në Vërboc, prandaj është logjike që të anulohen rezultatet në atë vendvotim. Nga gjithçka e thënë, ne mendojmë se ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të komunës së Klllokotit, Arber Emini, është e pabazuar dhe duhet të hidhet poshtë si e tillë.

Në përgjigjen në ankesë Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), të datës 14.10.2025, ka deklaruar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese në lidhje me kërkesën e juaj, KQZ jep sqarimet/përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 89 paragrafi 5 dhe 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, dhe Rregulloren Zgjedhore Nr. 12/2024 — Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, sipas nenit 10, paragrafët 5, 6, 7 dhe 8, përcaktohet procedura e detajuar për realizimin e votimit me asistencë. KQZ, pas pranimit të kërkesës nga PZAP, më datën 14.10.2025 ka kontaktuar me Komisionin Komunal të Zgjedhjeve (KKZ) të Komunës së Klllokotit, nga e cila ka marrë përgjigjen se: “Unë për atë rast jam vënë në dijeni vetëm pasi erdhën nga Prokuroria. Pas bisedës dhe pasi mësova se rasti i përmendur kishte ndodhur, menjëherë dërgova anëtarë të KKZ-së për të vizituar Vendvotimin dhe për të parë në vendin ngjarjes se çfarë kishte ndodhur në të vërtetë, duke kuptuar që një rast ka ndodhur dhe anëtarët kane reaguar dhe menjëherë e kane ndërprerë votimin e mëtutjeshëm me këtë vërtetim që është lëshuar nga ana e një mjeku. Me tutje ata të gjithë kane mundur të votojnë në mënyrë të rregullt në VV 3701/2” (shih të bashkangjitur deklaratën e KKZ).

Gjithashtu, ju njoftojmë se për këtë rast KKZ-ja e Komunës së Klllokotit ka raportuar në dhomën operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve, më datë 12.10.2025, duke deklaruar si në vijim: "Anëtarë i KKZ në komunën e Klllokotit ka njoftuar se një doktoreshe në Klllokot është duke lëshuar vendime për aftësi mjekësore me qëllim që këta votues të votojnë me asistencë. Doktoresha është duke lëshuar vendimet më datë 12.10.2025", (shih të bashkangjitur Raportin e Dhomës operative për ditën e zgjedhjeve).

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

- **Ankesa është e palejuar**

Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave, nuk hynë në kompetencë të PZAP për të vlerësuar apo verifikuar vërtetësinë e dokumentacionit mjekësor që ka pasur votuesja Gordana Jeriniq. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor me të cilin atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshoj, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor - faza e procesit zgjedhor kur parashtrëhet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e sipërsënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se *“PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”* dhe Neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendosja sikurse në dispozitiv të këtij vendimi për hedhjen e ankesave të palejueshme nuk e prejudikon rezultatin përfundimtar e po ashtu me të njëjtat pretendime ankimore palët mund ta atakojnë rezultatin përfundimtar.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.Anr.205/2025 më datën 15.10.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

A.A.nr.93/2025

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija - Ymeri, kryetare e kolegjit, Lumni Sallauka dhe Muhamet Rexha, anëtar të kolegjit, duke vendosur sipas ankesës së kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, të paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.205/2025, të datës 15.10.2025, në seancën e mbajtur më datë 20.10.2025, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, Prishet vendimi i Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZL.Anr.205/2025, i datës 15.10.2025, dhe çështja i kthehet Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) në rivendosje.

A r s y e t i m i

Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa, me vendimin ZL.Anr.205/2025, të datës 15.10.2025, ka vendosur: Hedhet e palejuar ankesa ZL.Anr.205/2025, e datës 13.10.2025, e parashtuar nga kandidatit i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, e paraqitur kundër subjektit politik Srpska Lista dhe subjektit politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

Kundër vendimit të lartpërmendur, kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën si të bazuar, të konstatohet se procesi zgjedhor në Komunën e Klllokotit është cenuar në mënyrë të rëndë dhe rezultatet nuk pasqyrojnë vullnetin e vërtetë të qytetarëve, të anulohet rezultati aktual i zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit, të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve në Komunën e Klllokotit nën kushte të sigurta, të lira dhe demokratike, me mbikëqyrje të shtuar dhe masa të forta kundër manipulimeve dhe të kërkohet hetim i plotë nga organet kompetente për ndërhyrjen e strukturave paralele serbe dhe shtetit të Serbisë në procesin zgjedhor.



PZAP, në përgjigje në ankesën e paraqitur të kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet ankimore dhe propozoi që ankesa e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZL.Anr.205/2025, i datës 15.10.2025.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 13.10.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, me të cilën pretendon se më datë 12.10.2025 në Zgjedhjet Lokale në Klllokot, Serbia ka ndërhyrë në sistemin Zgjedhor në Komunën e Klllokotit duke fabrikuar dëshmi mjekësore serbe të strukturave paralele për tu shfrytëzuar votuesit me asistencë të përdorin këtë vërtetim mjekësor.

Subjektit politik Srpska Lista dhe subjekti politik Srpska Narodna Sloga (SNS), kanë ushtruar përgjigje në ankesë, me të cilën e kanë kundërshtuar në tërësi ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini.

Pas pranimit të përgjigjes në ankesë të subjekti politik Srpska Lista dhe subjekti politik Srpska Narodna Sloga (SNS), PZAP-i, ka nxjerr vendimin ZL.Anr.205/2025, të datës 15.10.2025, me të cilën e ka hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini, duke vendosur si në dispozitiv të vendimit të ankimuar.

PZAP, në arsyetim të vendimit të saj ndër të tjera ka theksuar se: Paneli vlerëson se pretendimi i palës ankuese edhe pse i referohet parregullsive gjatë numërimit të votave, nuk hynë në kompetencë të PZAP-së, për të vlerësuar apo verifikuar vërtetësinë e dokumentacionit mjekësor që ka pasur votuesja Gordana Jeriniq. Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor me të cilin atakohet rezultati i cili është ende si rezultat preliminar, e i cili rezultat mund të ndryshojë, ankesa në këtë fazë të procesit zgjedhor është e parakohshme, për shkak se pas publikimit të rezultatit përfundimtar i njëjti rezultat është i ankimueshëm nga subjektet politike edhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numrin e votave të tyre. Meqenëse në aspektin kohor faza e procesit zgjedhor kur parashtrahet ankesa është e parakohshme ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme.

Ndër të tjera ka shtuar se në momentin e publikimit të rezultatit përfundimtar nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105.1 të Ligji Nr. 08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar.

Bazuar në arsyet e sipërshënuara dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parashihet se *"PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht"* dhe neni 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për



Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: *“në rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, PZAP-i, me vendim e hedh si të palejuar ankesën”*, lidhur me ankesën e lartë përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes nuk e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e PZAP, lidhur me hedhjen poshtë si të pa lejuar të ankesës të parashtruar nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës ka rezultuar se vendimi i PZAP-së, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe në kundërshtim me Rregulloren nr. 01/2025 të PZAP-së, dhe si rezultat i kësaj në mënyrë të gabuar është aplikuar e drejta materiale, duke e hedhur poshtë si të pa lejuar ankesën e parashtruar nga kandidati i pavarur për kryetar të Komunës së Klllokotit, Arber Emini.

Në lidhje me këtë, me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe me Rregulloren nr. 01/2025 të PZAP, rregullohen qartë kriteret dhe mënyrat e parashtrimit të ankesës në PZAP, e të cilave kriteret i ka përfillur parashtruesi i ankesës në rastin konkret.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në rastin konkret PZAP, gabimisht ka vendosur duke e hedhur si të pa lejuar ankesën e ankuesit, për faktin se:

Me nenin 119 paragrafi 1 të LZP-së, përcaktohet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-së, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të parashtrojë ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit dhe PZAP vendos për ankesën brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga parashtrimi i saj”*.

Me nenin 4 paragrafi 1 pika 1.11, të Rregullos nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, me të cilën përcaktohet se: *“1. Ankesë në PZAP, mund të parashtrojë personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur gjatë procesit zgjedhor: 1.11. të gjithë personat që kanë interes ligjorë të drejtat e të cilëve u janë shkelur ashtu siç përcaktohet me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Ligjin për Zgjedhjet Lokale dhe rregullat zgjedhore”*.

Me nenin 8 paragrafi 1 pika 1.2 të kësaj rregullore përcaktohet se: *“Personi sipas nenit 4 të kësaj rregullore, ka të drejtë ankesë në të gjitha fazat e procesit zgjedhor me pretendimin se i janë shkelur të drejtat e tij zgjedhore të përcaktuara më LZP-së, si në vijim: 1.2. nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, përfshi thyerjen e heshtjes zgjedhore në ditën e votimit si dhe për parregullsitë që ndërlidhen me procesin e votimit; 1.3. pas ditës së votimit deri në shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve”*.

Me nenin 9 paragrafi 1 dhe 5 pika 18 të kësaj rregullore përcaktohet se: *“1. Personi fizik ose juridik i cili ka interes ligjor mund të parashtrojë ankesë në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, të drejtat e të cilit janë shkelur sipas dispozitave të LZP-së ose rregullave zgjedhore”*. 5. Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara: 5.18. për shkeljet e pretenduara në ditën e votimit, nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit”.



Me nenin 10 paragrafi 1 pika 1.3, të kësaj rregullore përcaktohet se: “1. PZAP-ja për të gjitha ankesat që mund të parashtrihen si në nenin 9 të kësaj Rregulloreje, vendos brenda këtyre afateve: 1.3. ndërsa për ankesat që parashtrihen sipas nenin 9, paragrafit 5 nën paragrafit 5.3, 5.13, 5.15, 5.17, dhe 5.18 të kësaj rregullore, PZAP-i vendos brenda nëntëdhjetë e gjashtë (96) orëve nga momenti i pranimit të tyre”.

Nga dispozitat e lartcekura, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se PZAP, gabimisht ka vendosur kur e ka hedhur poshtë ankesën e ankuesit për faktin se nga pretendimet që dalin nga ankesa, i njëjti është ankuar për procesin dhe parregullsitë gjatë ditës së votimit dhe jo kundër rezultateve preliminare të tabuluara nga KQZ, ashtu siç ka pretenduar PZAP në vendimin e saj. PZAP, në rastin konkret gabimisht është mbështetur në dispozitën ligjore nga nenin 105 të LZP-së, për faktin se kjo dispozitë fletë për ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR dhe jo për parregullsitë lidhur me ditën e votimit, prej hapjes së qendrave të votimit e deri në mbylljen e tyre. Përveç kësaj, edhe mbështetja e vendimit të PZAP-it në nenin 13 paragrafi 6 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, parasheh rastin kur pala ankuese paraqet ankesë për rezultatet preliminare të tabuluara nga KQZ, e siç u cek më lartë ankesa nuk është ushtruar kundër rezultateve preliminare të tabuluara nga KQZ, e as kundër KQZ-së, por e njëjta është ushtruar ndaj subjekteve politike Srpska Lista dhe subjekti politik Srpska Narodna Sloga (SNS), për parregullsi gjatë ditës së votimit, e që realisht ankesa është dashtë të trajtohet në bazë të meritave dhe jo të hedhet poshtë si e pa lejuar.

Andaj, në rivendosje, PZAP, udhëzohet që ti evitojë shkeljet e theksuara si më lartë fillimisht sa i përket shkeljeve të dispozitave të LZP-së dhe Rregullores Nr.01/2025, dhe të vendos në mënyrë meritore lidhur me ankesën e kandidatit të pavarur për kryetar të Komunës së Killokotit, Arber Emini dhe pavarësisht nga rezultati të nxjerr vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.


GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.93/2025, datë 20.10.2025.

Kryetarja e kolegjit,
Franciska Zhitija - Ymeri



Republika e Kosovës  Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDJUJE


Funetori i autorizuar
Ovlašćeni radnik



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS/ SUDSKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



SEKRETARIATI I KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës
Oznaka spisi:

AA-93/2025

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL

DOSTAVNICA ZA LICNO DOSTAVLJANJE

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e kështë dëshitë të bëhet dorëzimi i sa pas tënjes së kuptimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendjet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit madhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtësës, fqut, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primilac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatečen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obavestjenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena, odaslom članu domaćina. Primilac nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primilacem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (dike e ngjitur në dërën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primilac odnosno član njegov domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primilaca (priblieno na vrtama stana odnosno prostorije gde primilac zaposlen)

Më _____ 201 _____ në ora _____ u _____ cas.

Shkaku i refuzimit të marrjes _____
Razlog odbijanja prijma _____

Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljača

Emri i shkresës që dorëzohet:
Naslov pisma koja se dostavlja:

AKTIVNOSTI

20.10.2025

Numri i shitojave: _____
broj priloga _____

Vënetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjale)
Povrdijeno prijem gorenavenog pisma
(i slovina)

(Nënskrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij)
Popis primilca ili licu koje je
pismeno primilo u zamenu)

AKTIVNOSTI 20.10.2025

Nënskrimi i dorëzuesit - popis dostavljača

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënskruajë dorëzuesi, duke shkruar shkaku pse marrësi nuk e ka vënë nënskrimin e vet. Ako je primilac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač, napomenom zasto primilac nije stavio svoj potpis.